



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2026/0027

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga U.D Kryetari i Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (LPP) në përbërje nga Batisha Ibrahim- Kryesuese, Vedat Poterqoi dhe Kimete Gashi-Brajshori-Anëtar të Panelit Shqyrtues duke vendosur sipas ankesës së Operatorit Ekonomik (OE) EING COM SH.P.K., kundër Vendimin për dhënie të një kontratë ose të një konkursi të projektimit të KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) lidhur me aktivitetin e prokurimit “163 Ndërtimi,rregullimi,vendosja dhe pastrimi i lumenjëve dhe kanalizimeve për mbrojtje nga vërshimet”-Ritender me numër të prokurimit 616-25-2547-1-1-1, me 26.02.2026, mori:

Vendim

1. Aprovohet, si e bazuar ankesa e OE EING COM SH.P.K., me nr. 2026/0027, e datës 10.01.2026, lidhur me aktivitetin e prokurimit “163 Ndërtimi,rregullimi,vendosja dhe pastrimi i lumenjëve dhe kanalizimeve për mbrojtje nga vërshimet”-Ritender me numër të prokurimit 616-25-2547-1-1-1.
2. Anulohet B58 Njoftimi mbi Vendimin e AK të KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES, ndërkaq aktiviteti i prokurimit “163 Ndërtimi,rregullimi,vendosja dhe pastrimi i lumenjëve dhe kanalizimeve për mbrojtje nga vërshimet”-Ritender me numër të prokurimit 616-25-2547-1-1-1 kthehet në Rivlerësim.
3. Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informojë OSHP për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, në të kundërtën, OSHP ka të drejtë të ndërmarrë masa ndaj AK për mos respektim të vendimit sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131 të LPP.
4. Kthehen mjetet e deponuara në emër të taksës tarifore për parashtrimin e ankesës në llogarinë e Operatorit Ekonomik EING COM SH.P.K.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 28.03.2025 KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES., duke vepruar në cilësinë e Autoritetit Kontraktues, ka publikuar Njoftimin për kontratë B05, për aktivitetin e prokurimit “163 Ndërtimi, rregullimi, vendosja dhe pastrimi i lumenjëve dhe kanalizimeve për mbrojtje nga vërshimet”-Ritender me numër të prokurimit 616-25-2547-1-1-1.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: furnizim, vlera e parashikuar e kontratës: 2,000,000.00 €.

Me 31.12.2025 KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES., duke vepruar në cilësinë e Autoritetit Kontraktues, ka publikuar Njoftimin mbi vendimin (B58), ku është rekomanduar për kontratë GOE: “**DIGA Solutions L.L.C.**”, “**ED - Construction SH.P.K.**” dhe “**IMK - Industria Metalike e Kosovës SH.P.K.**”.

Me 05.01.2026, OE ankues ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim ku me datë 08.01.2026 AK e ka refuzuar si të pa bazuar kërkesën për rishqyrtim.

Me 10.01.2025, OE **EING COM SH.P.K.**, ka parashtruar ankesë në OSHP, e cila është evidentuar me numër protokolli 2026/0027, duke e atakuar Vendimin e cituar si më sipër të AK, për dhënie të kontratës.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Organi Shqyrtues i Prokurimit ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Organi Shqyrtues i Prokurimit ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues **EING COM SH.P.K.**, janë parashtruar si në vijim:

Pretendimi Nr. 1

Arsyet e eliminimit sipas AK-së – Komisionit të vlerësimit janë:

- Kapaciteti teknik dhe profesional, kriteri numër katër (4): mungon Certifikata e Konformitetit CE që tregon përputhshmërinë e një produkti me standardet dhe kërkesat e Bashkimit Evropian për siguri, shëndet dhe mbrojtje mjedisore; certifikata është dorëzuar vetëm nga prodhuesi.

Sa i përket arsyes për eliminim lidhur me pretendimin e parë (1), kjo nuk qëndron, për faktin se kërkesa nga ana e AK-së ka qenë e përgjithshme, ku përcaktohet se: “Autoriteti kontraktues ka kërkuar kopje të certifikatës së konformitetit CE”. Në këtë rast, siç shihet, AK në kërkesën e dosjes nuk ka specifikuar se certifikata duhet të lëshohet nga një trup certifikues i pavarur (Notified Body) ose ndonjë institucion tjetër i akredituar; prandaj, me rastin e vlerësimit të ofertës sonë, ka dalë jashtë kërkesës së dosjes së tenderit, për të cilën ne nuk duhet të

eliminohemi në asnjë mënyrë.

Ne jemi të bindur se me dokumentacionin e ofruar nga ana jonë jemi të përgjegjshëm dhe e plotësojmë këtë kërkesë sipas përshkrimit të kërkesës së lartcekur.

Për më shumë, lidhur me këtë kërkesë, sipas legjislacionit të BE-së (Rregullorja 305/2011/EU), lejohet që për disa produkte vetë prodhuesi të lëshojë Deklaratën e Performancës dhe certifikatën CE, për aq kohë sa ndjek procedurat përkatëse dhe produkti i përket një kategorie të tillë që nuk kërkon domosdoshmërisht certifikim nga palë të treta.

Certifikata e ofruar nga ana jonë përmban të gjitha elementet thelbësore të një certifikate CE, e cila gjendet në ofertën tonë dhe mund të verifikohet lehtësisht nga AK:

- referencë të qartë ndaj direktivave të BE-së (si 305/2011/EU),
- përmendjen e standardeve të harmonizuara (p.sh. EN ISO 1452-2, EN ISO 15874, etj.),
- të dhënat e produktit dhe qëllimin e përdorimit,
- deklaratë për përputhshmëri me kërkesat e BE-së,
- shenjën CE dhe emrin/adresën e prodhuesit.

AK ka vepruar në kundërshtim me nenin 7 të LPP-së, sepse nuk ka trajtuar në mënyrë të barabartë të gjitha ofertat, pasi neve na ka eliminuar për certifikatën CE të lëshuar vetëm nga prodhuesi, ndërsa GOE-së të propozuar për dhënie të kontratës ia ka pranuar si të vlefshme edhe pse certifikata CE është e lëshuar nga vetë prodhuesi. Me këtë rast, AK nuk ka bërë vlerësimin në pajtim me nenin 7 të LPP-së, duke përdorur standarde të dyfishta gjatë vlerësimit të ofertave; për këtë arsye kërkojmë nga AK që ta kthejë lëndën në rivlerësim dhe ta korrigjojë gabimin e bërë në vlerësimin e tenderit.

Prandaj, kërkesa e autoritetit kontraktues ka qenë e përgjithshme dhe nuk ka përcaktuar apo specifikuar në mënyrë decitive se kush duhet ta lëshojë certifikatën; rrjedhimisht, ligjërisht dhe praktikisht, në mungesë të specifikimeve shtesë, certifikata e prodhuesit e dorëzuar nga ana jonë është plotësisht e vlefshme.

Pretendimi Nr. 2

Arsyeja numër dy (2) e eliminimit sipas Komisionit të Vlerësimit:

Specifikimet teknike të detyrueshme nuk i përmbushin kërkesat sipas kriterit të DT-së, ku:

Materiale: ofron PVC (standard) dhe PU (opsional). Siç u vlerësua më parë, këto materiale PVC dhe PU nuk i përmbushin kërkesat e specifikuara për materialet PP dhe PE. Ky është një defekt i rëndësishëm, pasi PP dhe PE janë të njohura për qëndrueshmërinë dhe fleksibilitetin e tyre në kushte të ndryshme klimatike, duke ndihmuar në zgjatjen e jetëgjatësisë së sistemit.

Kundërshtim ndaj arsyes së eliminimit sa i përket pikës së dytë:

Produktet e ofruara nga kompania jonë janë të dizajnuara për përdorim të përkohshëm gjatë situatave emergjente për vërshime, ku këta tuba prej PVC dhe PU janë të testuar për mbajtjen e presionit të ujit. Bazuar në këtë, materialet e ofruara nga ana jonë konsiderojmë se e përmbushin

dhe i përgjigjen 100% natyrës së kontratës dhe specifikimeve të dosjes së tenderit të kërkuara nga AK.

Pretendimi Nr. 3

Arsyeja numër tre (3) e eliminimit sipas Komisionit të Vlerësimit:

Lidhjet dhe ventilat: ofron ASTM Z dhe ASTM Universal për lidhjet e tubave. Kjo është një mangësi e dukshme, pasi kërkesa specifike në tender është për STORZ 110A. STORZ 110A është një standard ndërkombëtar dhe përdorimi i një lidhjeje tjetër mund të shkaktojë vështirësi në lidhjen e tubave me pajisje të tjera të përputhshme.

Kundërshtim ndaj arsyes së eliminimit tonë në lidhje me këtë pikë:

Sipas dokumentacionit të dorëzuar nga ana jonë dhe specifikimeve të katalogut zyrtar të prodhuesit, është cituar qartë: “Connectors ASTM, other on request”. Kjo do të thotë që lidhjet standarde janë të tipit ASTM, por prodhuesi ofron edhe tipe të tjera lidhjesh sipas kërkesës, përfshirë STORZ 110A, i cili është standard ndërkombëtar dhe i njohur gjerësisht në sistemet evropiane.

Në kuadër të ofertës sonë, kemi qenë të vetëdijshëm për këtë kërkesë të autoritetit kontraktues dhe kemi planifikuar pajisjen e tubave me lidhje STORZ 110A, siç e lejon dhe e përmend prodhuesi në dokumentacionin teknik.

Meqë autoriteti kontraktues nuk ka kërkuar specifikisht që lidhja STORZ të jetë standarde e produktit në katalog, por vetëm që të jetë pjesë e produktit të ofruar, dhe përderisa kjo është e mundur të ofrohet nga prodhuesi, konsiderojmë se kërkesa është përmbushur në përputhje me specifikimin teknik të tenderit.

Prandaj, eliminimi për këtë arsye konsiderohet joproporcional dhe i pabazuar, pasi produkti ofron fleksibilitet për të përmbushur këtë kërkesë dhe ne kemi deklaruar se furnizimi do të përfshijë STORZ 110A si lidhje standarde.

Pretendimi Nr. 4

Arsyeja numër katër (4) e eliminimit sipas Komisionit të Vlerësimit:

Pikat mbushëse: Nuk ka informacion të detajuar për mundësinë e lidhjes së pikës mbushëse në një pikë të vetme.

Kundërshtim ndaj arsyes së eliminimit tonë sa i përket pikave mbushëse nuk qëndron, sepse sipas kërkesave në Aneksin 1, pjesë e dosjes së tenderit, nuk është përmendur në mënyrë eksplicite kërkesa për lidhje të tubave mbushës në një pikë të vetme. Në dokumentacionin e specifikuar nga autoriteti kontraktues nuk gjendet asnjë pikë që e përcakton mënyrën e mbushjes në një pikë të vetme.

Katalogu dhe dokumentacioni teknik i ofruar nga kompania jonë përmbush të gjitha kërkesat specifike për diametrin, materialet, lidhjet me ventilat, kohëzgjatjen e mbushjes dhe funksionimin e tubave. Po ashtu, sistemi i propozuar nga ne është në përputhje me standardet dhe specifikimet teknike të kërkuara dhe garanton funksionimin efikas dhe të sigurt të mbrojtjes nga vërshimet.

Gjithashtu, AK – Komisioni i Vlerësimit gjatë fazës së vlerësimit ka kërkuar sqarime shtesë për çështje të tjera dhe, sipas letrës standarde për tenderuesin e eliminuar, ka cekur pretendime të tjera. Andaj, përderisa ka pasur mundësinë e sqarimit, nuk ka vepruar në harmoni të plotë me nenin 72 të LPP-së; për këtë arsye, vlerësimin nuk e ka bërë në mënyrë të drejtë. Ne jemi të gatshëm të ofrojmë sqarime dhe detaje shtesë teknike për lidhjen dhe funksionimin e sistemit, si dhe dokumentacion plotësues nëse kërkohet.

Bazuar në këto argumente, kërkojmë rishikimin e vendimit të eliminimit dhe pranimin e ofertës sonë, pasi nuk është e drejtë të eliminohemi për një kusht që nuk është specifikuar qartë në kërkesat e tenderit dhe që mund të sqarohet në mënyrë të plotë.

AK nuk ka të drejtë të na eliminojë për kërkesa të cilat nuk janë të specifikuar në dosjen e tenderit dhe njoftimin për kontratë, sepse kjo bie në kundërshtim me nenin 56.3 të LPP-së:

“56.3 i LPP-së – Tenderuesi, gjatë procedurave të hapura, ose kandidati, gjatë procedurave të kufizuara dhe procedurave të negociuara, pas publikimit të njoftimit të kontratës, nuk do të diskualifikohet ose përjashtohet nga procedurat e tilla në bazë të ndonjë kërkesë ose kriteri që nuk është i cekur në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit.”

Të gjitha pretendimet e përdorura nga AK kundrejt nesh si GOE janë të paqëndrueshme dhe këtë e vërteton Vendimi i OSHP-së; për rrjedhojë, të gjitha pretendimet ndaj nesh janë të gjykuara dhe të qarta në raport me përgjegjshmërinë tonë në këtë aktivitet të prokurimit, RES JUDICATA, neni 105, pika 2.16 e LPP-së.

Prandaj, kërkojmë nga AK që ta pranojë kërkesën për rishqyrtim nga ana jonë, ta respektojë Vendimin e OSHP-së me numër 535/2025, datë 19.08.2025, si dhe ta kthejë lëndën në rivlerësim, pasi GOE i rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm.

Pretendimet ndaj GOE të rekomanduar për kontratë

Sa i përket rivlerësimit të ofertave nga AK, pas qasjes në dokumentet e tenderit kemi vërejtur se GOE: DIGA Solutions L.L.C.; ED-Construction SH.P.K.; IMK – Industria Metalike e Kosovës SH.P.K., i propozuar për kontratë, nuk i plotëson kërkesat e DT-së dhe është i papërgjegjshëm në këtë aktivitet të prokurimit. Për më tepër, oferta e tij është 494,800.00 euro më e shtrenjtë se oferta jonë e përgjegjshme për këtë aktivitet të prokurimit.

Mangësitë për këtë GOE të rekomanduar paraqiten si në vijim:

Pretendimi 1 ndaj GOE të rekomanduar për kontratë

AK në dosjen e tenderit, përkatësisht në pikën 11.1 të DT-së – Krijimi i një grupi të operatorëve ekonomikë, pika f, ka kërkuar: plotësimin e Marrëveshjes (deklaratës) për themelimin e grupit, të vendosur në Aneksin 7.

Në këtë rast, GOE i rekomanduar për kontratë nuk ka ofruar deklaratën që i përgjigjet kërkesës në fjalë; prandaj, duke qenë se formulari i themelimit të grupit është obligativ sipas formës standarde, rrjedhimisht mosplotësimi i këtij formulari ashtu siç është përcaktuar rezulton se ky GOE është i papërgjegjshëm për këtë aktivitet të prokurimit. Për më tepër, dokumenti i ofruar nga ky GOE nuk përmban asnjë element të formularit standard të nxjerrë dhe publikuar nga KRPP për Aneksin 7 – Deklarata për themelimin e grupit.

Po ashtu, sipas Udhëzuesit Nr. 001/2023, i plotësuar dhe ndryshuar me Udhëzuesin Nr. 002/2024 për prokurim publik, thuhet se mungesa e deklaratës së qartë ku të gjithë anëtarët e grupit janë bashkërisht dhe individualisht përgjegjës rezulton në refuzimin e tenderit pa kërkuar informacion të mëtejshëm, si kusht administrativ. Meqenëse mungon deklarata sipas Aneksit 7 – Deklarata për themelimin e grupit, ky GOE duhet të eliminohej nga ky aktivitet i prokurimit.

Në këtë rast, AK ka bërë shkelje të LPP-së, përkatësisht të nenit 72, duke kërkuar sqarime shtesë për dokumente që konsiderohen si kushte administrative dhe për të cilat nuk duhet të kërkohet sqarim.

Deklarata për themelimin e grupit është publikuar në e-Prokurim dhe ka hyrë në fuqi më datë 11.11.2024; prandaj, kjo deklaratë duhet të plotësohet sipas rregullave dhe udhëzimeve të përcaktuara në të. Në të kundërtën, mosplotësimi i deklaratës sipas rregullave dhe udhëzimeve e bën GOE të papërgjegjshëm dhe duhet të eliminohet nga ky aktivitet i prokurimit.

Pretendimi 2 ndaj GOE të rekomanduar për kontratë

AK në dosjen e tenderit, te kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale, përkatësisht në pikat 9.1 dhe 9.2, në kërkesën numër 2 ka kërkuar:

“2. Operatorët ekonomikë duhet të dorëzojnë autorizim nga prodhuesi apo distributori i dedikuar për këtë projekt për shitje dhe mirëmbajtje për produktet kryesore me të cilat ofertojnë, si dhe garancion minimal 24 muaj nga prodhuesi për këto produkte.”

GOE i rekomanduar për kontratë ka prezantuar autorizim nga kompania Solomon Consultants d.o.o., Beograd – Savaski Venac, si përfaqësues i kompanisë Environment Solutions Asp, mirëpo nuk ka ofruar asnjë dëshmi se i njëjti është përfaqësues apo distributor i autorizuar nga Environment Solutions Asp për shitje të produkteve të tyre. Andaj, ky GOE i rekomanduar për kontratë nuk e plotëson kërkesën sipas dosjes së tenderit dhe, për këtë arsye, duhet të eliminohej nga ky aktivitet i prokurimit.

Pretendimi 3 ndaj GOE të rekomanduar për kontratë

AK në dosjen e tenderit, përkatësisht në Aneksin 1 – Specifikimet teknike, rezulton se ky GOE, sipas dëshmimeve të ofruara (katalogëve), nuk ka cituar askund se ka ofruar dëshmi për materialet PP dhe PE sipas kërkesës së dosjes së tenderit. Rrjedhimisht, ky GOE nuk i plotëson kërkesat teknike të detyrueshme dhe është i papërgjegjshëm në këtë aktivitet të prokurimit.

Pretendimi 4 ndaj GOE të rekomanduar për kontratë

AK në dosjen e tenderit, përkatësisht në Aneksin 1 – Specifikimet teknike, rezulton se ky GOE është i papërgjegjshëm për arsye se, për pikën Vinçi hidraulik, sipas dëshmimeve të ofruara nga GOE, i njëjti nuk ka ofruar certifikatat përkatëse që dëshmojnë përputhshmërinë e lidhjeve hidraulike me standardet ISO-16028 ose ISO-7241, Lloji A, siç kërkohet në dosjen e tenderit.

Pretendime ndaj GOE:

AGRO INVEST1 SH.P.K.; Beaver Schutzsysteme AG; LORD GROUP SH.P.K.; Ermal Sylaj B.I.

Sa i përket vlerësimit të ofertave nga AK, pas qasjes në dokumentet e tenderit kemi vërejtur se për GOE: AGRO INVEST1 SH.P.K.; Beaver Schutzsysteme AG; LORD GROUP SH.P.K.; Ermal Sylaj B.I., të gjitha pikat e eliminimit janë të qëndrueshme dhe këtë e vërteton Vendimi i OSHP-së. Prandaj, të gjitha pretendimet janë të gjykuara dhe të qarta në raport me eliminimin e këtyre GOE-ve në këtë aktivitet të prokurimit, RES JUDICATA, neni 105, pika 2.16 e LPP-së.

Pretendimi 1

AK në dosjen e tenderit, përkatësisht te Kapaciteti teknik dhe profesional, ka kërkuar:

“3. Operatorët ekonomikë duhet të sjellin katalogë ose broshura me specifikime të detajuara për produktet kryesore.”

GOE ka dorëzuar katalogë/broshura në gjuhën gjermane, gjë që është në kundërshtim me dosjen e tenderit, pasi sipas dosjes së tenderit, Përgatitja e Tenderit, pika 18 – Gjuha e Tenderit, pika 18.1, operatorët ekonomikë mund të përgatisin dhe të dorëzojnë tenderët e tyre dhe dokumentet e lidhura në gjuhën shqipe, serbe dhe angleze.

Kjo çështje është e rregulluar edhe sipas Rregullores Nr. 001/2022 për prokurim publik, neni 13 – Përdorimi i gjuhëve në dokumentet e prokurimit publik, pika 4, ku përcaktohet se një operator ekonomik mund të paraqesë një tender, kërkesë për pjesëmarrje apo dokument tjetër të kërkuar gjatë aktivitetit të prokurimit vetëm në gjuhën shqipe, serbe ose angleze.

Për këto arsye, eliminimi i këtij GOE është evidentuar edhe nga ana e AK-së përmes Letrës Standarde për tenderuesin e eliminuar; rrjedhimisht, ky GOE rezulton i papërgjegjshëm në këtë aktivitet të prokurimit.

Pretendimi 2

AK në dosjen e tenderit, përkatësisht te Kapaciteti teknik dhe profesional, ka kërkuar:

“5. Operatori ekonomik duhet të paraqesë një raport vlerësimi të vlefshëm për sistemin mobil për mbrojtjen nga vërshimet dhe përmbytjet. Raporti duhet të përmbajë të dhëna mbi efikasitetin teknik dhe performancën e sistemit të propozuar, të verifikuar nga një institucion i pavarur përkatës.”

Bazuar në dokumentacionin e prezantuar, GOE ka ofruar një raport mbi vlerësimin e sistemit mobil të përdorur nga Ministria e Punëve të Brendshme të Hungarisë dhe jo, siç ka qenë kërkesa, një raport të lëshuar nga një institucion relevant dhe i pavarur. Me këtë rast, GOE nuk e ka plotësuar kërkesën e dosjes së tenderit dhe rezulton i papërgjegjshëm në këtë aktivitet të prokurimit.

Pretendimi 3

AK në dosjen e tenderit, sipas Aneksit 1 – Kriteret teknike, ka kërkuar që sistemi mobil për mbrojtjen nga vërshimet të përmbushë specifikimet si në vijim:

Vinçi hidraulik

Vinçi hidraulik përdoret për të lehtësuar largimin dhe mbështjelljen e tubit pas përdorimit dhe duhet të përdoret së bashku me një pirun. Ai përbëhet nga një shasi dhe një bobinë e

zëvendësueshme. Duhet të përfshijë një motor hidraulik me fuqi minimale 40 kW dhe tuba hidraulikë me gjatësi të paktën 3 metra. Madhësia e vinçit dhe e bobinës duhet të jetë e tillë që 200 m tub të trefishtë të mund të mbështillen në një bobinë. Lidhjet hidraulike duhet të jenë në përputhje me ISO-16028 ose ISO-7241, Lloji A.

Bazuar në dokumentacionin e prezantuar, GOE nuk ka ofruar asnjë të dhënë teknike (dokument, katalog apo broshurë) sa i përket vinçit hidraulik; për këtë arsye, ky GOE rezulton i papërgjegjshëm në këtë aktivitet të prokurimit.

Gjithashtu, ekzistojnë edhe arsye të tjera për eliminimin e këtij GOE, të cilat janë evidentuar nga AK sipas Letrës Standarde për tenderuesin e eliminuar.

Pretendime ndaj GOE:

HARST Group SH.P.K.; EKOTERMIKA SH.P.K.

Pretendimi 1

OE nuk ka ofruar sqarime sipas Letrës Standarde për sqarim të dërguar me datë 27.05.2025.

Pretendimi 2

AK në dosjen e tenderit, përkatësisht të Kapaciteti teknik dhe profesional, ka kërkuar:

“1. Operatorët ekonomikë duhet të ofrojnë dëshmi se kanë përfunduar me sukses një kontratë të një natyre të ngjashme.”

GOE nuk ka ofruar asnjë kontratë të ngjashme për furnizime sipas kërkesës së AK-së; të gjitha kontratat e prezantuara janë kontrata për punë me kod 521 dhe jo për furnizime sipas aktivitetit 111.

AK në dosjen e tenderit aktivitetin e prokurimit e ka klasifikuar si FPP 28862100-3 – Furnizime tubash; rrjedhimisht, GOE rezulton i papërgjegjshëm në këtë aktivitet të prokurimit.

Pretendimi 3

AK në dosjen e tenderit, përkatësisht të Kapaciteti teknik dhe profesional, ka kërkuar:

“5. Operatori ekonomik duhet të paraqesë një raport vlerësimi të vlefshëm për sistemin mobil për mbrojtjen nga vërshimet dhe përmbytjet. Raporti duhet të përmbajë të dhëna mbi efikasitetin teknik dhe performancën e sistemit të propozuar, të verifikuar nga një institucion i pavarur përkatës.”

GOE ka ofruar një urdhër blerjeje të produkteve dhe jo raport vlerësimi, siç është kërkuar në dosjen e tenderit; për këtë arsye, GOE nuk e ka plotësuar këtë kërkesë dhe është i papërgjegjshëm në këtë aktivitet të prokurimit.

Pretendimi 4

AK në dosjen e tenderit, sipas Aneksit 1 – Kriteret teknike, ka kërkuar që:

“Ventilat lidhës duhet të jenë të standardit 4” Storz 110A dhe të sigurojnë mbushjen dhe zbrazjen e shpejtë të sistemit.”

Sipas katalogëve të prezantuar, GOE nuk ka ofruar specifikime teknike për ventilat sipas Aneksit 1, si pjesë e dosjes së tenderit; për këtë arsye, ky GOE rezulton i papërgjegjshëm.

Pretendimi 5

AK në dosjen e tenderit, sipas Aneksit 1 – Kriteret teknike, ka kërkuar specifikimet për vinçin hidraulik, siç janë cituar më lart.

Bazuar në dokumentacionin e prezantuar, GOE nuk ka ofruar asnjë të dhënë teknike (dokument, katalog apo broshurë) lidhur me vinçin hidraulik; rrjedhimisht, ky GOE rezulton i papërgjegjshëm në këtë aktivitet të prokurimit.

Gjithashtu, ekzistojnë edhe arsye të tjera për eliminimin e këtij GOE, të cilat janë evidentuar nga AK sipas Letrës Standarde për tenderuesin e eliminuar.

Përgjigja në kërkesën për rishqyrtim:

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar, si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritor (in meritum) të kërkesës.

Pretendimet ankimore të parashtruesit: Parashtruesi i kundërshton të gjitha arsyet eliminuese duke pretenduar se ato janë të pasakta dhe të pavërteta. Njëkohësisht pretendon se edhe tenderuesi i rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm për shkak të marrëveshjes për themelimin e GOE-së dhe specifikave teknike. Gjithashtu, parashtruesi pajtohet me eliminimin e ofertave tjera si të papërgjegjshme.

Sipas letrës standarde për tenderuesin e eliminuar, parashtruesi është shpallur si tenderues i papërgjegjshëm dhe është eliminuar për arsyet si në vijim:

Tenderi juaj është refuzuar për këto arsye:

Kapaciteti teknik dhe profesional, kriteri numër katër (4): mungon Certifikata e Konformitetit CE që tregon përputhshmërinë e një produkti me standardet dhe kërkesat e Bashkimit Evropian për siguri, shëndetësi dhe mbrojtje mjedisore; certifikata është dorëzuar vetëm nga prodhuesi.

Specifikimet teknike të detyrueshme nuk i përmbushin kërkesat sipas kriterit të DT-së, ku:

Materialet: ofron PVC (standard) dhe PU (opsional). Siç u vlerësua më parë, këto materiale PVC dhe PU nuk i përmbushin kërkesën e specifikuar për materialet PP dhe PE. Ky është një defekt i rëndësishëm, pasi PP dhe PE janë të njohura për qëndrueshmërinë dhe fleksibilitetin e tyre në kushte të ndryshme klimatike, duke ndihmuar në zgjatjen e jetëgjatësisë së sistemit.

Lidhjet dhe ventilat: ofron ASTM Z dhe ASTM Universal për lidhjet e tubave. Kjo është një mangësi e dukshme, pasi kërkesa specifike në tender është për STORZ 110A. STORZ 110A është një standard ndërkombëtar dhe përdorimi i një lidhjeje tjetër mund të shkaktojë vështirësi në lidhjen e tubave me pajisje të tjera të përputhshme.

Pikat mbushëse: nuk ka informacion të detajuar për mundësinë e lidhjes së pikës mbushëse në një pikë të vetme.

Lidhur me pretendimet ankimore të parashtruesit sa i përket arsyeve eliminuese të prezantuara në letrën standarde përmes së cilës parashtruesi është eliminuar si i papërgjegjshëm, është gjetur se arsyet e evidentuara nga komisioni vlerësues për eliminimin e parashtruesit si i papërgjegjshëm janë të sakta, të matshme dhe të ligjshme. Rrjedhimisht, është gjetur se eliminimi i parashtruesit është bërë në mënyrë të drejtë.

Ndërsa, sa i përket pretendimeve ankimore lidhur me tenderuesin e rekomanduar, është gjetur se, përderisa vetë parashtruesi ka dorëzuar ofertë të papërgjegjshme, i njëjti nuk mund të trajtohet fare si palë e interesuar në kuptim të nenit 4, paragrafi 1, nënparagrafi 26 i LPP-së. Pavarësisht kësaj, është gjetur se oferta e dorëzuar nga tenderuesi i rekomanduar është në përputhje të plotë me të gjitha kërkesat e DT-së, si dhe me specifikat teknike të DT-së. Pra, oferta e tenderuesit të rekomanduar është oferta e vetme e përgjegjshme në këtë aktivitet të prokurimit.

Në këtë mënyrë është gjetur se parashtruesi ka dorëzuar ofertë të papërgjegjshme, për të cilën me të drejtë është eliminuar nga aktiviteti i prokurimit, ndërsa të gjitha pretendimet e tij ankimore janë të pabazuara në tërësi.

Vlen të shtohet fakti se lidhur me këtë aktivitet të prokurimit deri më tani ekzistojnë dy (2) vendime të OSHP-së (2025/0535 dhe 2025/0560). Sipas këtyre vendimeve të OSHP-së, parashtruesi ka dorëzuar ofertë të papërgjegjshme. Pra, të gjitha arsyet për eliminimin e ofertës së parashtruesit janë të sakta, të qëndrueshme dhe të konfirmuara.

Nga sa u tha më sipër, është gjetur se parashtruesi nuk ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimet e tij. Prandaj, kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit është refuzuar si e pabazuar në tërësi.

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Organi Shqyrtues i Prokurimit me datë 13.01.2026 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 2026/0027, ndërsa me datë 20.01.2026 është dorëzuar raporti i ekspertit shqyrtues me nr. 2026/0027, me rekomandimet si në vijim Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK nuk është pajtuar pjesërisht rreth rekomandimeve të raportit të ekspertit shqyrtues, ndërsa OE është pajtuar lidhur me raportin e ekspertit shqyrtues.

Paneli shqyrtues ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për të vendosur mbi këtë lëndë pa seancë dëgjimore në kuptim të nenit 24 paragrafi 1 të Rregullores së Punës së OSHP-së duke marr parasysh që pretendimet e palëve dhe parashtruesat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritior lidhur me rastin.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Me qëllim të vërtetimit të drejtë gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova Raportin e Ekspertit Shqyrtues, parashtruesat dhe dokumentet e operatorit ekonomik ankues, shkresat dhe dokumentet e Autoritetit Kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimet e OE EING COM SH.P.K., eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2026/0027 ka vlerësuar si në vijim:

PËRSHKRIMI I ANKESËS

Me datën 10.01.2026, OE “EING COM SH.P.K.” – Prishtinë ka paraqitur ankesë në OSHP me nr. 2026/0027, kundër Njoftimit për dhënie të kontratës, në kuadër të aktivitetit të prokurimit “163 Ndërtimi, rregullimi, vendosja dhe pastrimi i lumenjve dhe kanalizimeve për mbrojtje nga vërshimet – Ritender”, me nr. të prokurimit 616-25-2547-1-1-1, iniciuar nga AK Kuvendi i Komunës së Prishtinës. Me këtë njoftim, AK ka rekomanduar për kontratë GOE “DIGA Solutions L.L.C.”; “ED - Construction SH.P.K.”; “IMK - Industria Metalike e Kosovës SH.P.K.”. Ankuesi konteston ligjshmërinë e vlerësimit dhe krahasimit të ofertave, duke pretenduar trajtim të pabarabartë dhe zbatim jo korrekt të kërkesave të Dosjes së Tenderit, si në raport me arsyet e eliminimit të tij, ashtu edhe në raport me përgjegjshmërinë e GOE të rekomanduar. Në ankesë theksohet se procedura ka qenë më herët objekt shqyrtimi në OSHP dhe përmenden vendimet OSHP 2025/0535 dhe OSHP 2025/0560 të datës 19.08.2025, të cilat lidhen me trajtimin e kësaj procedure dhe kthimin e lëndës në rivlerësim.

Ankuesi i referohet veçanërisht vendimit 535/2025, duke pretenduar se AK gjatë rivlerësimit/refuzimit të rishqyrtimit është thirrur në këto vendime, por i ka interpretuar ose zbatuar gabimisht, madje duke ngritur edhe çështjen si “res judicata”.

ANALIZA E EKSPERTIT SHQYRTUES

Eksperti shqyrtues ka analizuar pretendimet e OE ankues (G.O.E.) “EING COM” SH.P.K. & “MAVI DENIZ ÇEVRE HIZMETLERI” A.S., të paraqitura përmes Ankesës së datës 10.01.2026, lidhur me aktivitetin e prokurimit “163 Ndërtimi, rregullimi, vendosja dhe pastrimi i lumenjëve dhe kanalizimeve për mbrojtje nga vërshimet – Ritender”, me nr. të prokurimit 616-25-2547-1-1-1, të inicuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Kuvendi i Komunës së Prishtinës, duke u bazuar në ankesën dhe dokumentacionin përkatës të procedurës.

Në kuadër të kësaj analize, janë marrë në konsideratë edhe vendimet e mëhershme të Panelit/OSHP-së, përkatësisht OSHP: 2025/0535 dhe OSHP: 2025/0560, si dhe referencat në Vendimin e OSHP-së nr. 535/2025, të datës 19.08.2025, për aq sa këto lidhen me trajtimin e kësaj procedure dhe me aspektin e rivlerësimit.

Në vijim paraqiten pretendimet ankimore, të strukturuar sipas rendit të paraqitjes në ankesë.

A) Referenca kryesore e ankuesit: Vendimi i OSHP-së nr. 535/2025 (19.08.2025)

Në ankesën drejtuar OSHP-së, OE ankues “EING COM SH.P.K.” i referohet shprehimisht Vendimit të OSHP-së nr. 535/2025, të datës 19.08.2025, dhe e paraqet atë si bosht kryesor të arsytimit të tij. Ankesa, sipas ankuesit, është ndërtuar kryesisht mbi pretendimin se ky vendim ka përcaktuar qartë që GOE i rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm, ndërsa ankuesi është i vetmi OE/GOE i përgjegjshëm në këtë procedurë; përkundër kësaj, ankuesi pretendon se AK, pas kthimit në rivlerësim, e ka rekomanduar sërish të njëjtin GOE, duke mos e zbatuar vendimin e OSHP-së dhe obligimet që rrjedhin nga ai.

Po ashtu, OE ankues “EING COM SH.P.K.” thekson se në vendimin e AK për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim, AK është thirrur në vendimet e OSHP-së 2025/0535 dhe 2025/0560, por

sipas ankuesit këto vendime janë keqinterpretuar/zbatuar gabimisht, duke u anashkaluar gjetjet që – sipas tij – konfirmojnë përgjegjshmërinë e GOE të rekomanduar dhe përgjegjshmërinë e ankuesit.

Në këtë linjë argumentimi, OE ankues “EING COM SH.P.K.” shkon edhe më tej duke ngritur pretendimin që çështja të trajtohet si “res judicata” (çështje e gjykuar), duke iu referuar nenit 105, pika 2.16 të LPP-së, siç e citon në ankesë

B) Pretendimet lidhur me eliminimin e OE ankues

Pretendimi Ankimor nr. 1 (Certifikata e konformitetit CE)

OE ankues pretendon se AK e ka eliminuar me arsyetimin se, te kapaciteti teknik dhe profesional – kriteri nr. 4, “mungon certifikata e konformitetit CE”, përkatësisht se certifikata CE është dorëzuar vetëm nga prodhuesi.

Ankuesi e konteston këtë arsyetim duke theksuar se kërkesa e DT ka qenë e përgjithshme dhe AK ka kërkuar vetëm “kopje të certifikatës së konformitetit CE”, pa përcaktuar që ajo duhet të jetë e lëshuar nga trup i pavarur (Notified Body); prandaj, sipas tij, AK ka interpretuar kushtin më rreptë se sa është shkruar në DT.

Më tej, ankuesi i referohet Rregullores 305/2011/EU, duke pretenduar se për disa produkte lejohet që vetë prodhuesi të lëshojë dokumentacionin CE/Deklaratën e Performancës, dhe se certifikata e dorëzuar nga ai përmban elementet kryesore (referenca ligjore/standarde, të dhëna të produktit, deklaram përputhshmërie, shenjë CE).

Në fund, ankuesi pretendon shkelje të nenit 7 të LPP-së, sepse sipas tij AK e ka eliminuar ankuesin për CE “nga prodhuesi”, ndërsa GOE të rekomanduar ia ka pranuar certifikata të ngjashme, duke aplikuar standarde të dyfishta dhe kërkon kthim në rivlerësim.

Pretendimi Ankimor nr. 2 (Materialet – PVC/PU kundrejt PP/PE)

OE ankues “EING COM SH.P.K.” pretendon se eliminimi i tij nga AK është i pabazuar, pasi arsyeja e dytë e eliminimit nga Komisioni i Vlerësimit është se ofertuesi ka paraqitur materiale PVC (standard) dhe PU (opsional), të cilat – sipas AK-së – nuk i përmbushin kërkesat e DT-së për materialet PP dhe PE. AK e cilëson këtë si defekt të rëndësishëm, duke arsyetuar se PP dhe PE njihen për qëndrueshmëri dhe fleksibilitet në kushte të ndryshme klimatike dhe ndikojnë në zgjatjen e jetëgjatësisë së sistemit.

Në kundërshtim, ankuesi thekson se produktet e ofruara nga kompania e tij janë të dizajnuara për përdorim të përkohshëm në situata emergjente të vërshimeve, dhe se tubat prej PVC dhe PU janë të testuar për mbajtjen e presionit të ujit. Në këtë bazë, ankuesi pretendon se materialet e ofruara i përgjigjen 100% natyrës së kontratës dhe përmbushin specifikimet e dosjes së tenderit të kërkuara nga AK.

Pretendimi Ankimor nr. 3 (Lidhjet dhe ventilat – STORZ 110A)

OE ankues pretendon se arsyeja nr. (3) e eliminimit nga Komisioni i Vlerësimit është se te “Lidhjet dhe Ventilat” ka ofruar ASTM Z dhe ASTM Universal për lidhjet e tubave, ndërkohë që kërkesa specifike në tender është për STORZ 110A; AK e cilëson këtë si mospërputhje të dukshme, duke arsyetuar se STORZ 110A është standard ndërkombëtar dhe përdorimi i lidhjeve

të tjera mund të krijojë vështirësi në kompatibilitet me pajisje të tjera.

Në kundërshtim, ankuesi sqaron se në dokumentacionin teknik/katalogun zyrtar të prodhuesit është shënuar: “Connectors ASTM, other on request”, që sipas tij nënkupton se lidhjet standarde janë ASTM, por prodhuesi ofron edhe tipe të tjera sipas kërkesës, përfshirë STORZ 110A.

Ankuesi thekson se ka qenë i vetëdijshëm për këtë kërkesë të AK-së dhe se ka planifikuar që furnizimi të pajiset me lidhje STORZ 110A, siç e lejon prodhuesi.

Më tej, ankuesi pretendon se AK nuk ka kërkuar specifikisht që STORZ të jetë lidhje “standarde” e produktit në katalog, por vetëm që të jetë pjesë e produktit të ofruar; përderisa kjo është e mundur të ofrohet nga prodhuesi, ankuesi konsideron se kërkesa teknike është përmbushur, dhe eliminimi për këtë arsye është jo proporcional dhe i pabazuar.

Në fund, ankuesi kërkon rishqyrtimin e eliminimit dhe pranimin e këtij sqarimi si dëshmi të përmbushjes së kërkesës teknike, në frymën e trajtimit të barabartë dhe konkurrencës së drejtë.

Pretendimi Ankimor nr. 4 (Pikat mbushëse – “një pikë e vetme”)

OE ankues pretendon se arsyeja nr. (4) e eliminimit nga Komisioni i Vlerësimit është se për pikat mbushëse “nuk ka informacion të detajuar për mundësinë e lidhjes së pikës mbushëse në një pikë të vetme”.

Në kundërshtim, ankuesi thekson se kjo arsye nuk qëndron, sepse sipas kërkesave në Aneksin 1 të dosjes së tenderit nuk është përcaktuar në mënyrë eksplicite kërkesa që lidhja e tubave mbushës të realizohet “në një pikë të vetme”. Sipas ankuesit, dokumentacioni i AK-së nuk përmban asnjë pikë ku të specifikohet mënyra e mbushjes në një pikë të vetme, prandaj AK nuk mund të vendosë kushte shtesë gjatë vlerësimit që nuk janë kërkuar në DT.

Ankuesi pretendon se katalogu/dokumentacioni teknik i dorëzuar nga ai përmbush kërkesat e tenderit (diametri, materialet, lidhjet me ventilat, kohëzgjatja e mbushjes dhe funksionimi), dhe se produkti i ofruar është në përputhje me standardet për pajisje mbrojtëse emergjente. Po ashtu, ankuesi thekson se Komisioni i Vlerësimit nuk ka kërkuar sqarime shtesë për këtë aspekt, ndonëse ka pasur mundësi të kërkojë sqarime dhe “të mos veprojë në mënyrë të drejtë” duke eliminuar ofertën pa mundësi sqarimi; në këtë vijë, ankuesi e lidh këtë me nenin 72 të LPP-së.

Në mbështetje të këtij pretendimi, ankuesi i referohet edhe nenit 56.3 të LPP-së, duke theksuar se AK nuk ka të drejtë të diskualifikojë ofertuesit mbi baza/kërkesa që nuk janë të cekura në njoftimin për kontratë dhe në dosjen e tenderit.

Pretendimi Ankimor nr. 5 (Gjatësia e seksioneve – kërkesa 100–200 m)

OE ankues pretendon se arsyeja nr. (5) e eliminimit nga Komisioni i Vlerësimit lidhet me gjatësinë e seksioneve: sipas AK-së, ankuesi ka ofruar seksione vetëm deri në 20 metra, ndërsa në DT është kërkuar që seksionet të jenë 100 deri 200 metra të gjata, për shkak të përshtatjes në terrene të ndryshme, stabilitet, qëndrueshmërisë dhe presionit.

Në kundërshtim, ankuesi sqaron se në katalogun teknik janë të specifikuara seksione 10 m, 15 m dhe 20 m, ndërsa për gjatësitë e tjera është shënuar edhe opsioni “other on request” (pra, sipas kërkesës). Në këtë kuptim, ankuesi pretendon se ka kapacitet real të ofrojë edhe seksione 100 m dhe 200 m, siç kërkohet në tender, përmes konfigurimit “other on request”.

Ankuesi shton se sistemi është modular dhe lidhja e seksioneve realizohet në mënyrë të sigurt dhe efikase, duke krijuar gjatësinë e kërkuar, pa cenuar standardet e lidhjes, stabilitetin dhe qëndrueshmërinë nën presion. Sipas tij, DT nuk ka përcaktuar në mënyrë të detajuar që secili seksion duhet domosdoshmërisht të jetë “i vetëm” 100–200 m, por kërkesa duhet të kuptohet edhe si mundësi konfigurimi sipas terrenit dhe nevojës.

Në përfundim, ankuesi pretendon se eliminimi për këtë pikë nuk është i mbështetur në mënyrë objektive në dokumentacionin teknik dhe kërkon rishqyrtimin e vendimit dhe pranimin e ofertës së tij si përmbushëse e kërkesës për gjatësinë e seksioneve.

Pretendimi Ankimor nr. 6 (Sigurimi i tenderit – mospërputhja e numrit të prokurimit)

OE ankues pretendon se arsyeja nr. (6) e eliminimit nga Komisioni i Vlerësimit është se te sigurimi i tenderit, numri i prokurimit nuk përputhet me numrin e këtij aktiviteti të prokurimit, sipas DT-së.

Në kundërshtim, ankuesi e cilëson këtë arsye si absurde/joproporcionale, duke theksuar se sigurimi i tenderit i dorëzuar prej tij i përmban të gjitha elementet e nevojshme dhe se gabimi në numrin e prokurimit është një gabim formal që mund të konsiderohet si gabim teknik dhe jo bazë për eliminim, për më tepër kur dokumentacioni tjetër e identifikon qartë procedurën. Ankuesi pretendon se gjatë vlerësimit AK ka pasur mundësi ta verifikojë lehtësisht këtë dhe se nuk është dashur të eliminohet oferta për një mospërputhje të tillë.

Ankuesi shton se polica e sigurimit e paraqitur prej tij përmban elementet kryesore që e bëjnë të identifikueshme dhe të pranueshme për AK, si p.sh.: titulli i projektit, shuma e siguruar, periudha e mbulueshmërisë, data e skadimit dhe data e lëshimit.

C) Pretendimet ndaj GOE të rekomanduar për kontratë (DIGA Solutions L.L.C.; ED-Construction SH.P.K.; IMK – Industria Metalike e Kosovës SH.P.K.)

Pretendimi nr. 1 (Aneksi 7 / themelimi i grupit – pika 11.1(f) e DT)

OE ankues thekson se, pas qasjes në dokumentacionin e tenderit dhe vlerësimit të ofertave nga AK, ka konstatuar se GOE i rekomanduar për kontratë (DIGA Solutions L.L.C.; ED-Construction SH.P.K.; IMK – Industria Metalike e Kosovës SH.P.K.) nuk i plotëson kërkesat e Dosjes së Tenderit dhe, si rrjedhojë, është i papërgjegjshëm, ndërkohë që oferta e këtij GOE është edhe 494,800.00 € më e lartë se oferta e ankuesit.

Në këtë kuadër, ankuesi parashton pretendimin e parë ndaj GOE të rekomanduar, duke deklaruar se AK në Dosjen e Tenderit (pika 11.1(f)) ka kërkuar që, në rast të grupit të operatorëve ekonomikë, të dorëzohet Marrëveshja/Deklarata për themelimin e grupit, e vendosur në Aneksin 7, si formular standard që dëshmon krijimin e grupit dhe përgjegjësinë e përbashkët dhe individuale të anëtarëve.

Sipas ankuesit, GOE i rekomanduar për kontratë nuk e ka ofruar këtë deklaratë sipas formës standarde (Aneksi 7) dhe dokumentacioni i dorëzuar nga GOE nuk përmban elementet e formularit standard të publikuar sipas rregullave të prokurimit publik. Ankuesi thekson se kjo kërkesë është kusht administrativ dhe obligativ, i cili nuk mund të “sanohen” me sqarime pas hapjes, dhe për këtë arsye GOE duhet të eliminohet nga procedura.

Në përfundim, ankuesi kërkon që ky mosplotësim i Aneksit 7 të trajtohet si mangësi thelbësore e ofertës së GOE të rekomanduar, duke rezultuar në refuzimin e ofertës si të papërgjegjshme dhe rivlerësimin e procedurës në përputhje me kërkesat e DT-së.

Pretendimi nr. 2 (Autorizimi nga prodhuesi/distributori – pikat 9.1 & 9.2)

OE ankues pretendon se AK, në kuadër të kërkesave për mundësitë teknike dhe/ose profesionale (pikat 9.1 & 9.2 të Dosjes së Tenderit), ka kërkuar që operatorët ekonomikë të dorëzojnë autorizim nga prodhuesi ose distributori i deklaruar, për produktet kryesore, përfshirë edhe angazhimin për shitje dhe mirëmbajtje, si dhe garancion minimal 24 muaj për produktet.

Sipas ankuesit, GOE i rekomanduar për kontratë ka paraqitur autorizim nga kompania Solomon Consultants d.o.o. (Beograd – Savajski Venac) si përfaqësuese e kompanisë Environment Solutions Asp, por nuk ka ofruar asnjë dëshmi që kjo kompani është realisht përfaqësues apo distributor i autorizuar i “Environment Solutions Asp” për shitje dhe mirëmbajtje të produkteve përkatëse. Për këtë arsye, ankuesi pretendon se GOE i rekomanduar nuk e plotëson kërkesën e DT-së, dhe si rrjedhojë oferta e tij duhet të vlerësohet e papërgjegjshme dhe GOE të eliminohet nga aktiviteti i prokurimit.

Pretendimi nr. 3 (Materialet PP/PE – Aneksi 1, Specifikimet teknike)

OE ankues pretendon se GOE i rekomanduar për kontratë nuk i përmbush kërkesat teknike të Dosjes së Tenderit, konkretisht kërkesën për materialet PP dhe PE të përcaktuara në Aneksin 1 – Specifikimet teknike. Sipas ankuesit, nga dëshmitë e ofruara (katalogu) i GOE të rekomanduar nuk rezulton askund se janë ofruar ose dëshmuar materialet PP dhe PE sipas kërkesës së DT-së. Për këtë arsye, ankuesi pretendon se GOE i rekomanduar duhet të vlerësohet i papërgjegjshëm dhe të eliminohet nga aktiviteti i prokurimit.

Pretendimi nr. 4 (Vinçi hidraulik – ISO 16028 / ISO 7241 Type A)

OE ankues pretendon se GOE i rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm edhe për shkak të mospërmbushjes së kërkesave teknike në Aneksin 1 – Specifikimet teknike lidhur me vinçin hidraulik. Sipas ankuesit, nga katalogu/dëshmitë e ofruara nga GOE i rekomanduar nuk rezulton se vinçi hidraulik i ofruar është në përputhje me standardet e kërkuara, përkatësisht ISO 16028 ose ISO 7241, Lloji A (siç është kërkuar në DT). Ankuesi pretendon se GOE i rekomanduar nuk ka paraqitur certifikatat përkatëse që do të dëshmonin përputhshmërinë me këto standarde, prandaj kërkon që GOE të vlerësohet i papërgjegjshëm dhe të eliminohet nga aktiviteti i prokurimit.

D) Pretendimet ndaj GOE: AGRO INVEST1 SH.P.K.; Beaver Schutzsysteme AG; LORD GROUP SH.P.K.; Ermal Sylaj B.I.

Pretendimi nr. 1 (Dokumentacioni teknik/katalogu – gjuha e dokumenteve)

OE ankues pretendon se, sipas Dosjes së Tenderit, te Kapaciteti teknik dhe profesional është kërkuar që operatorët ekonomikë të dorëzojnë katalogë ose broshura me specifikime të detajuara për produktet kryesore, dhe se dokumentacioni i ofertës duhet të jetë në gjuhën e përcaktuar nga AK (shqip/anglisht).

Sipas ankuesit, ky GOE ka dorëzuar katalog/broshurë në gjuhën gjermane, çka – sipas tij – është në kundërshtim me Dosjen e Tenderit, pasi dokumentacioni i dorëzuar në procedurë duhet të jetë në gjuhën shqipe ose angleze. Ankuesi thekson se AK nuk ka kërkuar që këto dokumente të përkthehen gjatë vlerësimit dhe se dorëzimi i dokumenteve në gjuhë tjetër nuk përbën përmbushje të kërkesës së DT-së.

Në këtë bazë, ankuesi pretendon se GOE nuk i plotëson kërkesat e tenderit dhe duhet të vlerësohet i papërgjegjshëm në këtë aktivitet të prokurimit, duke theksuar se kjo arsye është evidentuar edhe nga AK përmes Letrës Standarde për tenderuesin e eliminuar.

Pretendimi nr. 2 (Raporti i vlerësimit të sistemit – verifikim nga institucion i pavarur)

OE ankues pretendon se, sipas Dosjes së Tenderit, te Kapaciteti teknik dhe profesional është kërkuar që operatorët ekonomikë të paraqesin raport të vlerësimit të sistemit për “sistem mobil për mbrojtje nga vërshimet dhe përmbytjet”, dhe se ky raport duhet të përmbajë të dhëna mbi performancën/efikasitetin teknik të sistemit të propozuar, të verifikuara nga një institucion i pavarur.

Sipas ankuesit, bazuar në dokumentacionin e paraqitur, GOE ka ofruar raport vlerësimi për sistemin që pretendohet se është përdorur nga Ministria e Punëve të Brendshme e Hungarisë, mirëpo ankuesi thekson se, përderisa kërkesa ka qenë që raporti të jetë i lëshuar/verifikuar nga institucion relevant i pavarur, GOE nuk e ka plotësuar këtë kusht. Për këtë arsye, ankuesi pretendon se GOE rezulton i papërgjegjshëm dhe duhet të eliminohet nga aktiviteti i prokurimit.

Pretendimi nr. 3 (Vinçi hidraulik – mungesë katalogu/dëshmish teknike dhe standardet ISO)

OE ankues pretendon se, sipas Dosjes së Tenderit (Aneksi për kriteret teknike të “sistemit mobil për mbrojtje nga vërshimet”), GOE duhet të përmbushë kërkesat për vinç hidraulik dhe të dorëzojë dokumentacion teknik (katalog/broshurë) që dëshmon specifikimet dhe përputhshmërinë. Ankuesi përmbledh kërkesën teknike se vinçi hidraulik duhet të mundësojë largimin e mbështjellësës pa përdorim force, të jetë i montuar në shasi me bobinë të zëvendësueshme, të ketë bobinë të motorizuar me fuqi minimale 4.0 kW, dhe të jetë i tillë që mund të mbështjellë/mbajë sistemin në bobinë. Po ashtu, ankuesi thekson se lidhjet hidraulike duhet të jenë në përputhje me ISO 16028 ose ISO 7241 Lloji A.

Sipas ankuesit, nga dokumentacioni i paraqitur nga GOE nuk rezulton asnjë e dhënë teknike (dokument/katalog/broshurë) që e përshkruan vinçin hidraulik dhe parametrat e tij, prandaj GOE, sipas tij, nuk e ka dëshmuar përmbushjen e kërkesave dhe duhet të vlerësohet i papërgjegjshëm në këtë aktivitet. Ankuesi shton se ekzistojnë edhe arsye të tjera për eliminim të këtij GOE, të cilat sipas tij janë evidentuar nga AK në Letrën Standarde për tenderuesin e eliminuar.

E) Pretendimet ndaj GOE: HARST Group SH.P.K.; EKOTERMIKA SH.P.K.

Pretendimi nr. 1 (Kontrata të ngjashme – natyra e kontratës)

OE ankues pretendon se AK, në kuadër të kërkesave për kapacitetin teknik dhe profesional, ka kërkuar që operatori ekonomik të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses një kontratë të një natyre të ngjashme.

Sipas ankuesit, GOE HARST Group SH.P.K.; EKOTERMIKA SH.P.K. nuk ka paraqitur kontrata të ngjashme për “furnizime” sipas kërkesës së AK-së. Ankuesi thekson se kontratat e paraqitura nga ky GOE janë për pozicionin 521 dhe jo për furnizime sipas aktivitetit përkatës (siç kërkohet), prandaj pretendon se ky GOE nuk e plotëson kriterin e kontratave të ngjashme dhe duhet të vlerësohet i papërgjegjshëm në këtë aktivitet të prokurimit.

Pretendimi nr. 2 (Raporti i vlerësimit të sistemit – mungesë e raportit dhe e udhërrëfyesit)

OE ankues pretendon se AK, në kuadër të kërkesave për kapacitetin teknik dhe profesional (kërkesa nr. 5), ka kërkuar që operatori ekonomik të paraqesë raport të vlerësimit të sistemit mobil për mbrojtje nga vërshimet dhe përmbytjet, ku raporti duhet të përmbajë të dhëna për performancën/efikasitetin teknik të sistemit të propozuar, të verifikuara nga institucion i pavarur.

Sipas ankuesit, GOE HARST Group SH.P.K.; EKOTERMIKA SH.P.K. nuk ka ofruar as udhërrëfyes (manual) të produkteve, dhe as raportin e vlerësimit të kërkuar në Dosjen e Tenderit. Për këtë arsye, ankuesi pretendon se ky GOE nuk e plotëson kërkesën e DT-së dhe duhet të konsiderohet i papërgjegjshëm në këtë aktivitet të prokurimit.

Pretendimi nr. 3 (Valvulat/lidhjet – STORZ 110A dhe mungesë specifikimesh teknike)

OE ankues pretendon se, sipas Dosjes së Tenderit dhe Aneksit 1 – Kriteret teknike, sistemi mobil për mbrojtje nga vërshimet duhet të përmbushë kërkesën që valvulat/lidhjet të jenë të standardit 4" STORZ 110A, në mënyrë që të sigurohet mbushja dhe zbrazja e shpejtë e sistemit.

Sipas ankuesit, GOE HARST Group SH.P.K.; EKOTERMIKA SH.P.K., në katalogët e paraqitur, nuk ka ofruar specifikat teknike për valvulat sipas kërkesës së Aneksit 1 të dosjes së tenderit. Për këtë arsye, ankuesi pretendon se ky GOE nuk i plotëson kërkesat teknike dhe duhet të vlerësohet i papërgjegjshëm në këtë aktivitet të prokurimit.

Pretendimi nr. 4 (Vinçi hidraulik – mungesë katalogu/dëshmish teknike dhe standardet ISO)

OE ankues pretendon se, sipas Dosjes së Tenderit dhe Aneksit 1 – Kriteret teknike, sistemi mobil duhet të përmbushë kërkesat për vinç hidraulik, i cili përdoret për lehtësimin e largimit të mbështjellës dhe operimin e sistemit. Ankuesi thekson se vinçi duhet të jetë i montuar në shasi me bobinë të zëvendësueshme, të ketë bobinë të motorizuar me fuqi minimale 4.0 kW, të mundësojë mbështjelljen e tubit dhe të ketë lidhje hidraulike në përputhje me ISO 16028 ose ISO 7241, Lloji A.

Sipas ankuesit, bazuar në dokumentacionin e paraqitur, GOE HARST Group SH.P.K.; EKOTERMIKA SH.P.K. nuk ka ofruar asnjë të dhënë teknike (dokument/katalog/brosurë) lidhur me vinçin hidraulik, prandaj nuk e ka dëshmuar përmbushjen e kërkesave dhe duhet të vlerësohet i papërgjegjshëm në këtë aktivitet të prokurimit. Ankuesi shton se ekzistojnë edhe arsye të tjera për eliminim të këtij GOE, të cilat sipas tij janë evidentuar nga AK në Letrën Standarde për tenderuesin e eliminuar.

Përgjigje e Ekspertit Shqyrtues

Eksperti shqyrtues sqaron se, përveç ankesës aktuale, ka analizuar edhe ankesën paraprake të OE ankues “EING COM SH.P.K.” me nr. 2025/0535, të datës 26.06.2025, si dhe të gjithë dokumentacionin përkatës të procedurës së prokurimit, përfshirë raportin e vlerësimit fillestar,

raportin e rivlerësimit dhe aktet e Autoritetit Kontraktues. Eksperti sqaron se, në ekspertizën paraprake, ka trajtuar pretendimet e OE ankues dhe ka dhënë vlerësimin e tij profesional mbi bazën e dokumentacionit të administruar në atë fazë; ndërkaq, pas shqyrtimit nga Paneli Shqyrtues, ankesa e OE “EING COM SH.P.K.” është aprovuar si e bazuar, me anulimin e Njoftimit mbi Vendimin e AK-së (B58) dhe kthimin e lëndës në rivlerësim.

Nga shqyrtimi i këtyre shkresave, eksperti konstaton se ankesa aktuale është identike me ankesën paraprake, si për nga përmbajtja faktike dhe juridike, ashtu edhe për nga arsyet thelbësore të eliminimit të OE ankues. Po ashtu, nga dokumentacioni i rivlerësimit rezulton se arsyetimi eliminues i AK-së ka mbetur i njëjtë, ndërsa rezultati procedural ka mbetur i pandryshuar, me rekomandimin për kontratë të të njëjtit GOE.

Në këtë kontekst, eksperti sqaron se Paneli Shqyrtues, me vendimet OSHP: 2025/0535 dhe OSHP: 2025/0560, të datës 19.08.2025, ka vendosur në esencë: aprovimin si të bazuar të ankesës së OE “EING COM SH.P.K.”, anulimin e Njoftimit mbi Vendimin e AK-së (B58) dhe kthimin e lëndës në rivlerësim. Në kuadër të këtij vendimi, Paneli ka vënë në pah edhe faktin se oferta e OE ankues rezulton më e lirë për 494,800.00 krahasuar me OE/GOE të rekomanduar për kontratë nga AK.

Paneli ka trajtuar në mënyrë të veçantë edhe pretendimet e ankuesit ndaj GOE të rekomanduar për kontratë dhe ka konstatuar mangësi të natyrës së kushteve administrative eliminuese, si dhe pasiguri të tjera në dokumentacionin e këtij GOE. Në këtë drejtim, Paneli ka konstatuar se, ndonëse GOE i rekomanduar ka dorëzuar deklarata individuale të ndara nga DIGA Solutions L.L.C. (lider), ED-Construction Sh.P.K. (anëtar) dhe IMK Sh.P.K. (anëtar), këto deklarata nuk e përmbajnë Marrëveshjen/formularin standard për themelimin e grupit, të miratuar nga KRPP, i cili është obligativ për operatorët ekonomikë që marrin pjesë si grup; nuk i përmbajnë përqindjet e pjesëmarrjes së anëtarëve; dhe nuk përcaktojnë ndarjen e përgjegjësi/detyrave të secilit anëtar të grupit. Paneli ka vlerësuar se, në përputhje me nenin 10.1 të Udhëzuesit Operativ Nr. 001/2023 (i ndryshuar me 002/2024), mungesa e formularit standard për themelimin e GOE-së përbën kusht administrativ eliminues, për të cilin nuk lejohet sqarim apo plotësim pas dorëzimit të ofertës. Po ashtu, Paneli ka evidentuar edhe pasiguri dhe mangësi të tjera në dokumentacionin e GOE-së së rekomanduar për kontratë, përfshirë mungesën e dëshmisë/konfirmimit nga vetë prodhuesi (Environment Solutions AsP) që vërteton statusin e Solomon Consultants si përfaqësues zyrtar/distributor i autorizuar, mungesën e dëshmimeve të plota për materialet PP dhe PE, siç është kërkuar, si dhe mungesën e referencave/dokumenteve që dëshmojnë përputhshmërinë e lidhjeve hidraulike me standardet ISO-16028 ose ISO-7241 Type A, sipas kërkesave të specifikimeve teknike.

Në lidhje me OE ankues, Paneli kishte konstatuar se eliminimi i OE “EING COM SH.P.K.” është bërë në kundërshtim me nenet 1, 6, 7, 59 dhe 60 të LPP-së, si dhe se arsyetimi i AK-së i shprehur në Letrën Standarde për eliminimin e këtij OE ka qenë i pabazuar. Në mënyrë të përmbledhur, Paneli kishte konstatuar se për produktin në fjalë zbatohet sistemi AVCP 4, i cili lejon vetë-certifikimin pa nevojë për “notified body”; se materialet e ofruara PVC/PU janë të dizajnuara për përdorim emergjent dhe i përgjigjen natyrës së kontratës, në përputhje me nenin 6 dhe nenin 59.4 të LPP-së; se operatorët ekonomikë nuk mund të eliminohen për kritere që nuk janë të përcaktuara qartë në Dosjen e Tenderit; dhe se gabimet teknike në sigurimin e tenderit nuk e bëjnë ofertën të papranueshme kur dokumenti ekziston para afatit për dorëzim dhe përmban elementet thelbësore. Eksperti thekson se këto konstatime paraqesin udhëzime të qarta për rivlerësimin dhe duhej të merreshin parasysh nga Autoriteti Kontraktues gjatë procesit të

rivlerësimit.

Nga dokumentacioni i rivlerësimit rezulton se Autoriteti Kontraktues ka ruajtur të njëjtat arsye thelbësore të eliminimit ndaj OE EING dhe ka nxjerrë të njëjtin rezultat procedural, duke rekomanduar përsëri të njëjtin GOE për kontratë. Në këto rrethana, ankesa aktuale paraqitet identike në përmbajtje me ankesën paraprake, si për nga pretendimet ashtu edhe për nga shkaqet kryesore të kontestimit, meqë arsyetimi eliminues dhe trajtimi i GOE të rekomanduar nuk rezultojnë të jenë ndryshuar në substancë. Kjo situatë sugjeron se rivlerësimi nuk rezulton të ketë reflektuar në mënyrë të mjaftueshme gjetjet dhe orientimet e vendimit paraprak të Panelit, si në raport me eliminimin e OE ankues ashtu edhe në raport me trajtimin e kushteve administrative eliminuese për GOE të rekomanduar për kontratë.

Eksperti evidenton gjithashtu se edhe pretendimet e ngritura ndaj operatorëve të tjerë ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë, të cilat kanë qenë të trajtuara në kuadër të shqyrtimit paraprak nga Paneli, paraqiten në substancë të njëjta dhe nuk rezulton të jenë paraqitur rrethana të reja materiale përtej atyre që tashmë janë shqyrtuar në vendimmarrjen paraprake.

Përfundim

Eksperti shqyrtues vlerëson se, duke marrë parasysh rrjedhën procedurale të lëndës, faktin se arsyetimi eliminues ka mbetur i njëjtë edhe pas rivlerësimit, ruajtjen e të njëjtit rekomandim për kontratë, si dhe konstatimet e Panelit si në raport me OE ankues ashtu edhe me GOE të rekomanduar për kontratë, pretendimet e OE “EING COM SH.P.K.” në ankesën aktuale janë të bazuara. Eksperti i propozon Panelit Shqyrtues që të aprovojë ankesën e OE “EING COM SH.P.K.” si të bazuar, të anulojë njoftimin mbi vendimin e AK-së të nxjerrë pas rivlerësimit dhe ta kthejë lëndën në rivlerësim të mirëfilltë, me udhëzim të qartë që Autoriteti Kontraktues të zbatojë gjetjet e vendimit paraprak të Panelit, përfshirë trajtimin e plotë dhe të njëtrajtshëm të kushteve administrative eliminuese për GOE të rekomanduar për kontratë, duke siguruar trajtim të barabartë dhe vlerësim objektiv të ofertave.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur dhe objektive, me ndërgjegje dhe kujdes profesional ka vlerësuar të gjitha provat e rastit. Në këtë mënyrë është gjetur se Autoriteti Kontraktues nuk ka vepruar në përputhje me dispozitat ligjore për prokurimin publik dhe kërkesat e dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit “163 Ndërtimi, rregullimi, vendosja dhe pastrimi i lumenjëve dhe kanalizimeve për mbrojtje nga vërshimet”-Ritender me numër të prokurimit 616-25-2547-1-1-1.

Paneli Shqyrtues, për këtë aktivitet ka njerur vendime parapare me nr: OSHP 2025/0535 dhe OSHP 2025/0560, të datës 19.08.2025. poashtu PSH administroi të gjitha shkresat e kësaj lënde, përfshirë aktet dhe veprimet e AK, parashtresat dhe provat e ankuesit dhe raportin e ekspertit shqyrtues dhe duke i analizuar të gjitha ato në kontekstin e përgjithshëm të kësaj çështje ka krijuar bindjen e pavarur e tij/sajë, se ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar. Në këtë rast Paneli shpjegon se raporti i ekspertizës është hartuar në mënyrë profesionale dhe i njëjti i përmban të gjitha pohimet ankimore dhe analizat lidhur me to, duke i shpjeguar në mënyrë specifike në raport me dispozitat e shkelura, sikurse kërkohet kjo së paku me dispozitën e nenit 113 dhe 114 të LPP-së. Si rrjedhojë, Paneli Shqyrtues e mbështet rekomandimin e ekspertit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe lënda të kthehet në ri-vlerësim.

Paneli vlerësues sipas vlerësimit të pavarur të tij në kuptim të nenit 105, duke e pasur parasysh kërkesën e nenit 104, paragrafi 1, të Ligjit të cituar sipas të cilit, cituar: “Procedura e shqyrtimit të prokurimit do të zbatohet dhe realizohet në mënyrë të shpejtë, të drejtë dhe pa diskriminim, që ka për qëllim zgjidhjen e drejtë, të ligjshme dhe efektive të lëndës...” si dhe në harmoni me nenin 1, të LPP, sipas të cilit, qëllimi i këtij Ligji është mes tjerash, cituar: “...të siguroj integritetin dhe përgjegjësinë e zyrtarëve publik, nëpunësve civil dhe personave të tjerë që kryejnë ose janë të përfshirë në një aktivitet të prokurimit duke kërkuar që, vendimet e individëve të tillë dhe baza ligjore e faktike për vendimet e tilla, të mos ndikohen nga interesat personale, të karakterizohet me jo-diskriminim dhe me një shkallë të lart të transparencës dhe të jenë në përputhje me kërkesat procedurale dhe qenësore të këtij ligji”. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP-së, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Paneli Shqyrtues, pas shqyrtim të gjitha fakteve dhe argumenteve ka ardhur në përfundim se AK gjatë zhvillimit të këtij aktiviteti të prokurimit nuk ka respektuar dispozitat ligjore të LPP-së, kështu që urdhëron AK-në që gjatë rivlerësimit të këtij aktiviteti të prokurimit të ju përmbahet në tërësi dispozitave ligjore të LPP-së.

Andaj, duke vepruar në pajtim me kompetencat e cituara si më sipër dhe nenin 104 paragrafi 4 lidhur me paragrafin 1, sipas të cilit procedura e shqyrtimit të prokurimit do të zbatohet dhe realizohet në mënyrë të shpejtë, të drejtë dhe pa diskriminim, që ka për qëllim zgjidhjen e ligjshme dhe efektive të lëndës, si dhe duke ju referuar nenit 117 të LPP-së, dhe në provat e prezantuara si më lartë Paneli Shqyrtues vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Batisha Ibrahim

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES**
- **OE - EING COM SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: